

INSTITUTI I FOLKLORIT  
NEXHAT AGOLLI

Valle  
të  
Krahinës



se Lumës



398  
A37

INSTITUTI I FOLKLORIT

NEXHAT AGOLLI

V A L L E  
TË  
KRAHINËS SË LUMËS

~~35496~~

KRRIJTESIA E SHTETIT  
SHKENCËR

39076



TIRANË, 1964

**Kopertina dhe skicat  
nga  
ZEF SHOSHI**

**Tirazhi: 1000**

**Formati 70x100/16**

**Stash: 2204-55**

**Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë**

## PARATHANIE

«Valle popullore Lumjane» asht botimi i parë i këtij lloji në vendin tonë, që i paraqitet artdashësve, ansambleve profesioniste, amatorëve, koreografëve, si dhe atyne që interesohen për studimin e valleve popullore.

Në këtë botim përmbledhen pesë valle: Këllicoja e parë, Këllicoja e dytë, Përpjeta, Krah më krah dhe Shkepza (në dy variante).

Për transkriptimin e këtyne valleve si pikmbështetje ne kemi pasë sistemin<sup>1)</sup> e transkriptimit të valleve të aplikuem prej sektorit të koreografisë pranë Institutit të Folklorit të Bukureshtit.

Ky asht hapi i parë në këtë rrugë të vështirë. Në kërkim të vazhdueshkëm, tue pasë parasysh dhe realizimet ndërkombëtare në fushën e transkriptimit të valleve, ne shpresojmë ma në fund të gjejmë një metodë, e cila të mund t'i shprehi në mënyrë sa ma të lehtë, sa ma të plotë, sa ma të kuptueshme karakteristikat nacionale të valleve tona popullore. Por, duhet të theksojmë se, këtë mënyrë transkriptimi që muerrëm për bazë ne ja përshtatëm përgjithësisht ndërtimit të valleve tona, veçanërisht valleve të cilat po i paraqesim në këte botim.

Ky sistem, mendojmë se i pasqyron qartë aspektet e valles, tue i zëbërthye ato në të gjitha pjesët përbamëse, në të gjithë detaljet. Vallja ndahet në pjesë; çdo pjesë e saj ndahet në figura; çdo figurë në variacione figurash. Sejcila figurë, ose variacion i saj, ka lëvizjen, e cila shkruhet me një alfabet të veçantë dy geramat e të cilit emërtohen me vlefte noshat të ngjashme me ato të muzikës.

Në përshkrimin e çdo figure në veçanti ne i japim randësi: koreografisë dhe lëvizjes.

Koreografinë e paraqesim thjesht: sa masa muzike përmbledhen në këte figurë; qëndrimi i trupit dhe të kapunit e valltarëve dhe në fund drejtimi i ekzekutimit të lëvizjes.

Transkriptimin e lëvizjes e ndajmë simbas masave të muzikës. Nga e majta shënojmë masat, kurse nën te notat përkatëse të saj, që në të njëjtën kohë janë dhe vlefte ritmike të hapave të lëvizjes. Ndërsa nga e djathta përkundrejt me notat bajnë përshkrimin me fjalë të çdo hapi.

---

1) Vera Proca — Ciortea: Despre notarea dansului popular romenesc, in «Revista de folclor» an I, nr. 1-2, 1956, si an II, nr. 1-2 1957.

*Në këtë rast, e kam për nder të falenderoj «Kino-Studio Shqipëria e re» (operatorin H. Ferhati, kolektivin e repartit të montazhit që drejtohet nga I. Balla) për ndihmën që më dhanë në filmimin, si dhe kushtet e favorëshme teknike që më krijuan për transkriptimin e këtyne valle.*

*Shpresoj të përfitoj në vërejtjet e artdashësve, kërcimtarëve profesionistë, amatorëve, koreografëve dhe atyne që merren me studimin e valle kombëtare shqipëtare, mendimet e të cilëve do të na ndihmojnë për botimet e tjera në t'arthmen.*

**NEXHAT AGOLLI**

## H Y M J E

Krahina e Lumës shtrihet në pjesën V.L. të Shqipnisë. Nga jugu kufizohet me Dibrën, me të cilën i ndan prroji i Veleshicës, nga veriu me Hasin me të cilin i ndan Drini i Bardhë, nga lindja me Gorën (Jugosllavi), ndërsa nga perëndimi Drini i Zi i ndan prej Fanit të Mirditës dhe Malit të Zi (krahinë që administrativisht sot formon lokalitetin e Shëmërisë). Krahina e Lumës, bashkë me Hasin, Malin e Zi, Fanin e Gorën, formon rrethin e Kukësit.

Ka një popullsi prej 50 mijë banorë. Qendra ma me randësi është qyteti i vogël i Kuksit i ndërtuëm mbi një bregore atje ku bashkohet Drini i Zi me Drinin e Bardhë. Hijerandë pranë i qëndron Mali i Gjalicës 2487 m. Gjithkrah e rrethojnë kodra të blerueme.

Vendasit merren me blegtori dhe bujqësi. Lumjanët janë të përmendun për rritjen e deles rudë. Zejtaria shtëpijake për përpunimin e shajakut, qylymave, sexhadevet ka qenë gjithmonë mjeshtëri e grave lumjane. Sot është ngritur në Bicaj një punishte zejtarie për punimin e qylymavet dhe sexhadevet, të cilat eskportohen edhe jashtë vendit. Në bujqësi kultivohet ma shumë misri, thekna. Prodhohen llojet të ndryshme perimesh dhe frutash.

Lumjanët janë puntorë të zot e të palodhun. Nga trupi janë mesatarë, pak të thatë. Mbjajnë në përgjithësi musteqe të holla. Gjithnji i shef të veshun me kostumet e tyne nacionale.

Ashtu si Shqipnia e veriut edhe krahina e Lumës në luftë për mbrojtjen e Atdheut, gjatë historisë ka dhanë kontributin e saj. E nëpërmjet fjalës dhe kangës këto ngjarje u kënduan dhe u trashëguen brez mbas brezi deri në ditët tona. Por e madhe është fuqia krijuese e këtyne malsorëvet veçanërisht te vallet popullore. Sikundër kangët epike, lirike, legjendat, meloditë, ato janë manifestime artistike, në të cilat populli shpreh forcën e madhe krijuese, ndjenjat e tija.

Mendoj se Luma është dhe mbetet ndër krahinat ma origjinale, ma të pasuna dhe ma interesante përse i përket valleve popullore, jo vetëm si ndërtim, ekzekutim, por dhe nga përmbajtja e tyne. Fondin kryesor të këtyne valleve e përbajnë: **Këlliçoja e Parë, Këlliçoja e dytë, Përppjeta, Gishtë më gisht, Krah më krah, Mërsela, Vallja e hajdutit, Shkepza, Dramçja**, etj., të cilat, jo vetëm njihen në të gjitha katundet e krahinës, por edhe luhen. Katundet që shquhen në këto kërcime ma shumë janë: Shtiqni, Bicaj, Nanga, Bushtrica, Gora si dhe katunde të tjerë që zgjaten deri në Vernicë të Kosovës. Si kërcimtarë të zot, që mbahen në gojë është Qamil Zyberi (Belush), Hysni Avdijs (Bushtricë), e mbi të gjithë Imer Shehi me grupin e tij (Shtiqën).



Siç na tregon informatori Imer Shehi e të tjerë, këto valle janë shumë të vjetra e të trashëgueme brez mbas brezi; thonë gjithashtu për këto valle se kanë qenë të luftës d.m.th. përpara se me shkue me luftue kundra anmikut. Këtë e përlligj vetë ndërtimi, mjetet që përdoren dhe emërtimi i valleve. Nga kjo ne kuptojmë lidhjen e këtyne kërcimeve me ngjarjet në jetën e përditshme qysh prej kohnavet ma të largëta.

**Këlliçoja e parë** asht temeli i valleve — siç thonë lumjanët. Në këtë valle bahet paraqitja e armëve (shpatave) dhe përplasja e tyne. Prej vitit 1950 e kënde (ndoshta dhe ma parë), kjo valle nuk luhet ma me shpatë; në dorën e djathtë sejcili valltar mban shaminë.

**Këlliçoja e dytë**, që disa e quejnë nga pikpamja e ndërtimit motër e vogël e Këlliçosë së parë, tregon një kuvend burrash përpara luftimit. Valltarët të veshun me dollamë mbajnë në qafë kamishin (një lloj çibuku i gjatë), për brezit silahin dhe në te qesen e duhanit. Ndër duer mbajnë eshkën, unurin dhe bricin (hekurin dhe strallin). E vejnë kamishin në gojë dhe, deri sa e ndezin, vetëm atëhere e marrin vallen; kërcëjnë randë randë, tue pi duhan, tue qitë shtëllunga tymi e tue u pa me një vështrim të rreptë. Edhe kjo valle prej kohësh ka marrë trajtë tjetër. Vërtet vallja luhet n'at mënyrë, por nuk përdoren ma kamishi, silahi me qesen e duhanit, as eshka, unuri dhe brici.

Mbas kësaj vjen **Përpyeta** (nga vetë emni kuptojmë një kërcim me hudhje). Në këtë valle jepet besa në çastin kur valltarët hudhen në qendër të rrethit.

Në fund luhet vallja **Gisht më gisht** (kërcehet e kapun gisht më gisht) dhe mbas saj vallja **Krah më krah**. Karakteristikë e këtij kërcimi asht se, valltarët kërcëjnë të kapun krah më krah. Simbas informatorëve — tue i dhanë krahun shoqi shoqit, ata na kujtojnë çastin kur burrat niseshin dikur motit për në luftë.

Interesante asht edhe vallja e Shkepzës. Në këtë shofim elemente humoristikë, të cilët jo vetëm përlligjin përmbajtjen e valles, po japin dhe një larmi në gjith kompleksitetin e lëvizjeve të valleve të kësaj krahine. Informatorë të ndryshëm e lidhin këtë valle me një moment lufte; dikush tregon për një luftar çalaman, i cili ka mbetë prapa shokëve në luftë, e që mundohet mos me u nda prej tyne; dikush tjetër tregon për një luftar, i cili mbas lufte asht plagosë dhe prej plagëve mezi kërcen.

Ajo që i karakterizon në përgjithësi vallet e Lumës e që i dallon në krahasim me ato të krahinave të tjera, asht mënyra e randë dhe burrnore e ekzekutimit të tyne. Nga pikpamja e ndërtimit, vallet paraqiten të thjeshta, të larmishme, me një plastikë të atillë që e ven trupin në një plan me lëvizjet e kambëvet, të duerve e, që kërkon një virtuoizitet për t'i këcye. Teknika e valleve karakterizohet nga një dinamikë, që buron nga mbrenda dhe e qëndrueshme. Nga pikpamja e kategorizimit pa përjashtim të gjitha vallet luhet në grup dhe ekzekutohen me nga katër-gjashtë e ma shumë persona. Vallet luhet në rreth të hapët dhe sejcili kërcimtar i ekzekuton lëvizjet veças (në vallen Këlliçoja e parë, Këlliçoja e dytë, Përpyeta), në gjysëm rrethi të hapun (në vallen Krah më krah, Shkepza, Gisht më gisht), si dhe në vijë të drejtë nga mbrapa përpara, në rreth dhe anasjelltas (në vallen Mërsela) etj.

Këto kërcime në asnjë mënyrë nuk mund t'i marrim të shkëputuna prej muzikës e cila i shoqon. Dy vegla karakteristike, të thjeshta, përbajnë orkestrën e këtyre valleve: curlja dhe lodra (daullja). Curlja i jep valles vijën melodike, kurse lodra ritmin pa të cilin ajo nuk mund të shprehet. Çdo lëvizje e kambëvet, ngrejtje, vendosje në tokë, kryqëzim n'ajër,

hudhje ose ulje, të gjitha këto lidhen ngushtë, kondicionohen me të ramit e çakiçit të lodrës (shkopi me të cilin i bihet lodrës) dhe graxës (thupër e hollë me të cilën i bihet lodrës me dorën e majtë). Curlja dhe lodra janë ato që i ftojnë, që i ndezin valltarët me kërcye.

Sot këto valle luhen në raste festash nacionale, ditë përkujtimi të ngjarjeve dhe festash lokale.

Në festivalet folkloristike të zhvillueme në Tiranë qysh prej vitit 1949, valltarët lumjanë shpesh herë kanë zanë vende nderi, kanë marrë diploma e çmime.

Bukuria dhe origjinaliteti i këtyne valleve i ka kapërcye tashma kufijt e krahinës. Sot këto valle njifen në të gjithë territorin shqiptar.

### TREGUESI I SHENJAVE

Për orientimin e trupit, ose çvendosjen e tij, përdoren shenjat e drejtimit nëpër të cilat lëviz trupi dhe hapat, tue u mbështetë në pikën e orientimit simbas skemës së njoftun.

Pika 1 = Përpara (drejt qendrës).

Pika 2 = Diagonal përpara djathtas (gjysëm djathtas).

Pika 3 = Anash nga e djathta.

Pika 4 = Diagonal mbrapa djathtas.

Pika 5 = Mbrapa.

Pika 6 = Diagonal mbrapa majtas.

Pika 7 = Anash nga e majta.

Pika 8 = Diagonal përpara majtas (gjysëm majtas).







Fig. 1

Në shënimin e lëvizjes përdoren shigjetat drejtuese; maja e shigjetës tregon drejtimin e hapave, kurse bishti (coda)

tregon odientimin e trupit në raport me drejtimin e hapave p.sh: 


= hapat bahen anash nga e djathta (drejt pikës 3), kurse trupi orientohet përpara (drejt pikës 1).  = hapat bahen anash nga e djathta (drejt

pikës 3), kurse trupi orientohet gjysëm djathtas. (drejt pikës 2).  = Hapat bahen gjysëm majtas (drejt pikës 8), kurse trupi orientohet përpara (drejt pikës 1).

Shigjeta e vendosun në fillim të një grupi hapash tregon drejtimin e tyre, për derisa të vijë në tjetër shenjë treguese.

Numuri i gradëve përsipër një shkronje (që përfaqëson hapin) tregon ngrejtjen e kambës përpara, anash, mbrapa simbas shkallës respektive.

Shigjeta dhe numuri i gradëve përsipër një, ose disa shkronjave, tregojnë ndryshimin e drejtimit n'orientimin e trupit.

 = Rrotullimi në vend 360° djathtas, nga poshtë nalt në formë spirale.



## Përshkrimi i lëvizjeve

Këtu poshtë po japim tipet kryesore të hapave, që janë përdorë në përshkrimin e valleve p.sh:

- a) Me hapa të vegjël, ose hapa të mdhaja kuptojmë hapa të dimensioneve të ndryshme nga ai normal.
- b) Hap kali i vogël me të djathtën përpara, me të majtën, ose kryq.
- c) Hapa normal, të thyem, hap çalamani etj. Ngrejtje e kambës së thyeme përpara, kryq, anash, mbrapa.
- d) Hudhje prej njenës kambë në tjetrën, hudhje mbi të njejtën kambë të thyeme në vend, ose hudhje prej dy kambëve mbi një kambë.
- e) Ulje e madhe (grand plyie) mbi të dyja kambët të hapuna.
- f) Rrotullim i trupit mbi njenën kambë në vend, ose në hecje.

### Qëndrimi i trupit dhe lëvizjet e duerve

Pjesë përbamëse e gjithë lëvizjeve, në valle, asht dhe qëndrimi i trupit. Pjesa e sipërme e tij (busti) asht pjesa ma e qëndrushme, ma e shtrëngueme; në ndonji rast asht i lëvizshëm mesi i trupit, si p.sh. në vallen **Përpjeta**. Kjo i jep elasticitet trupit në kërcim.

Nji funksion, jo ma të pakët, në këtë valle kanë dhe duert. Në mënyrën e përshkrimit që kemi përdorë, lëvizjet e duerve nuk i kemi shprehë me ndonjë shenjë të veçantë, ashtu sikundër kemi veprue me lëvizjet e kambëve, po i kemi përshkrue vetëm me fjalë. Lëvizjet e duerve nuk mund t'i kuptojmë të ndame prej lëvizjeve të kambëve, ose qëndrimit të trupit, po në nji lidhje organike midis tyre. Asht për t'u vue re se: sa herë që çohet kamba e djathtë, ose e majta n'ajër, çohen dhe duert; kur hecet, ose hudhet prej njenës kambë në tjetrën, lëvizin dhe duert. Kjo shifet ma tepër në vallet ku kërcimtarët kërcenë sejcili veças. Në vallen **Përpjeta** p.sh, ngrejtja e duerve n'ajër, sikur shëmbëllen me krahët e nji zogu në fluturim; kaq forcë shprehje kanë duert. Në vallen **Këlliçoja e parë**, **Përpjeta**, kërcimi zakonisht fillon me lëvizjen e duerve. Edhe në vallen **Krah më krah**, **Shkepza**, ku të katër valltarët janë të kapun krah më krah, i pari veçanërisht dhe i fundit, e lëvizin dorën bashkë me shaminë n'ajër simbas ndrrimit të hapave.

a) — Shenjat e hapave dhe vlefta ritmike e tyre.

Kambët që ekzekutojnë lëvizjet shënohen: me shkronjën **D** kamba e djathtë dhe **S** kamba e majtë. Aspektet e tjera të këtyne shkronjave tregojnë vleftën ritmike të hapave.

**D S** — Vleftë gjysëm note

**D S** — Vleftë nji e katërt

**d s** — Vleftë nji e tetë

**d s** — Vleftë nji e gjashtëmbëdhjet

Nga vetë konstrukti ritmik i ndërtimit të valleve ne do kemi të bajmë vetëm me shkronjat, që kanë vleftë ritmike: gjysëm note, nji të katërt dhe nji të tetë.

Kur një lëvizje ekzekutohet përnjherë me të dyja kambët, të dyja këto shkronja lidhen me një hark të vogël nën te. P.sh: **DS**

b) Shenja + e vendosun përsipër një shkronje, ose përpara një grupi shkronjash, tregon se hapat ekzekutohen në vend.

c) Shenja të tjera për hapat

Në tokë:

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hap kali i vogël përpara

$\hat{S}$

— Hap kali kryq përpara

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hap pak i thyem

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hap i thyem (demie plyie)

$\hat{D} \hat{S}$

— Ulje e madhe (grand plyie) me të dyja kambët

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hap pak në maqë të gishtave

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Ngrejtje pak në majë të gishtave në vend dhe ulje

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Ulje dhe ngrejtje e lehtë (jo e plotë) në vend.

N'ajër:

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Ngrejtje e kambës përpara e thyeme 45°, 90° mbi kambën bazë.

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Ngrejtje e kambës mbrapa e thyeme 45° mbi kambën bazë.

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Kryqëzimi i kambës së thyeme përpara 45°, 90° n'ajër

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Kryqëzim i kambës së thyeme mbrapa 45° n'ajër.

Hudhjet:

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hudhje mbi njenën kambë.

$\hat{D} \quad \hat{S}$

— Hudhje prej kambës së djathtë mbi të majtën dhe anasjelltas.

$\hat{D} \hat{S} \hat{D}$

— Hudhje prej të dyja kambëve mbi të djathtën.

d) Pushimet

Gjatë ekzekutimit të lëvizjeve, në valle, ndodh që të kemi ndalesa. Këto ndalesa quhen pushime dhe janë të ngjashme me shenjat respektive, që përdoren dhe në muzikë.

} — Pushim një të katërt

7 — Pushim një të tetë

7 — Pushim një të gjashtëmbëdhjetë

Në përshkrimin e valleve ne do të kemi të bajmë vetëm me pushimin  $1/4$  dhe  $1/8$ .

e) Shenjat përsëritëse.


Në qoftë se një numur hapash përsëriten disa herë përdorim këtë shenjë:  $| n x$

Përsëritja e një numuri të caktuar hapash tregohet me shifrën për-

katëse pranë së cilës vëhet shenja  $x$ :  $\overset{\wedge}{D} \overset{\wedge}{S} / 4x$

ë) Për të treguar ndryshimin e drejtimit të trupit në vend, ose çvendosjen e hapit në drejtime të ndryshme përdorim shigjetën ndihmëse →

## KËLLIÇOJA E PARË



Skica Nr. 1

Rasti: luhet në të gjitha rastet.  
Gjinia: valle burrash.  
Formacioni: në rreth të mbyllun.  
Të kapunit: sejcili valltar kërcen veças.  
Koha: 2/4.

largo  = 56.

### Karakteristikat

Këllicoja e parë asht valle burrash. Luhet në rreth të mbyllun. Sejcili valltar kërcen veças. Vallja asht e përbame prej: hecjes (shetitjes) dhe kërcimit.

Në hecje, që asht çasti përpara fillimit të kërcimit, valltarët hecin me hap të lirë njeni mbas tjetrit nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepavet të sahatit, ndërsa curlja dhe lodra bijnë.

Kërcimi (pjesa e parë e valles) përbahet prej dy figurash. Figura e parë ekzekutohet në vend. Rolin kryesor këtu e luen dora e djathtë, e cila rrotullon shaminë n'ajër. Figura e dytë përbahet prej lëvizjes së parë, që asht lëvizja bazë e valles dhe, prej një lëvizje tjetër, që asht variation i lëvizjes së parë.

Lëvizjet karakteristike të valles janë: lëvizje duersh, hecje në gjysëm ulje me të dyja kambët përpara, anash; ulje me të dyja kambët me

rrotullimin e trupit gjysëm djathtas, gjysëm majtas, hap kali i vogël etj. E gjithë vallja ekzekutohet në dymbëdhjet masa muzike, por ajo mund të ripërsëritet.

## Hecja

Mbasi ka fillue me ra curlja dhe lodra, kërcimtarët, të shkëputur njeni prej tjetrit, hecin me hap të lirë në rreth nga e djathta; në dorën e djathtë mbajnë shaminë. Bahet gjysëm, ose gati një rreth i plotë, deri sa i pari i valles ndalet për ta fillue kërcimin (zakonisht nuk ka caktim, mund të zgjasi katër masa ose ma tepër). Simbas të parit veprojnë të gjithë. Skica Nr. 1.

### Pjesa e parë

#### Figura e parë

- Përmbledh dy masa muzikore me kohën 2/4.
- Pozicioni fillestar i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth, në distanca të barabarta njeni prej tjetrit, me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në vend.

#### Lëvizja



#### Përshkrimi i lëvizjes

##### Masa I



- Kamba e djathtë qëndron pranë së majtës, pak e thyeme, në majë të gishtave. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njejtën kohë, dora e majtë asht në pozicionin normal, kurse e djathta çohet nalt me shaminë.

##### Masa II



- Trupi dhe kambët qëndrojnë n'at pozicion. Në të njejtën kohë, dora e djathtë rrotullon shaminë n'ajër.



- Ulje dhe ngrajtje e lehtë me të dyja kambët në vend. Në të njejtën kohë, dora e djathtë del përpara tue e rrotullue shaminë përmbrenda.


Formula ritmike e figurës së parë



#### Figura e dytë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën 2/4.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepavet të sahatit.

## Lëvizja



### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I



— Hap (kali i vogël me të djathtën anash nga e djathta (e majta thyhet pak në vend), tue e kthye trupin gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi shkon pak përpara dhe mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa. Skica Nr. 2.



— I njejtë hap me të djathtën. Në të njejtën kohë dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara.

#### Masa II



— I njejtë hap me të djathtën. Në të njejtën kohë dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.



— Kamba e majtë afrohet pranë së djathtës, e thyeme në majë të gishtave (kamba e djathtë dhe trupi drejtohen në pozicionin normal), me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Në të njejtën kohë, dora e majtë vendoset mbrapa në bel e thyeme, kurse e djathta del nalt.



— Ulje dhe ngrejtje e lehtë me të dyja kambët në vend. Në të njejtën kohë dora e majtë qëndron mbrapa në bel, kurse e djathta del përpara tue rrotullue shaminë përmbrenda.



Skica Nr. 2


### Masa III



- Hap me të majtën, të thyeme anash nga e majta drejt pikës 7. Trupi mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del anash, kurse e djathta ulet poshtë në pozicionin normal.



— Kamba e djathtë afrohet pranë së majtës, e thyeme, në majë të gishtave( e majta çohet në pozicionin normal), me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara, pak e thyeme, kurse e djathta shkon diagonal mbrapa. Skica Nr. 3.



### Masa IV



— Trupi kthehet gjysëm majtas në vend drejt pikës 1. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del nëalt pak e thyeme.



— Ulje dhe ngrejtje e lehtë me të dyja kambët në vend. Në të njejtën kohë, dora e majtë qëndron në vend, kurse e djathta del përpara tue rrotullue shaminë përmbrenda.

Formula ritmike e figurës së dytë




Skica Nr. 3

Variacioni i figurës së dytë

- Përmbledh gjashtë masa muzikore në kohën 2/4.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen drejt qendrës me rrotullimin e trupit 180° në vend dhe dalje nga qendra në rreth të hapët.



## Lëvizja



Skica Nr. 4

### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I

- Hap kali i vogël me të djathtën përpara (e majta thyhet pak në vend) drejt pikës 1. Trupi shkon pak përpara dhe mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa. Shif skicën Nr. 2.
- Hap kali i vogël kryq me të majtën përpara (e djathta ngrehet dhe ulet pak në vend). Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal përpara, kurse e djathta del përpara e thyeme.

#### Masa II

- Hap kali i vogël me të djathtën (e majta ngrehet dhe ulet pak në vend) tue u rrotullue trupi 90° nga e majta. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
- I njejtë hap me të majtën me rrotullimin e trupit 90° nga e majta. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.

#### Masa III

- I njejtë hap me të djathtën me rrotullimin e trupit 90° nga e majta. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
- I njejtë hap me të majtën, me rrotullimin e trupit 90° nga e majta. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.

#### Masa IV

- Hap kali i vogël me të djathtën përpara (e majta ngrehet dhe ulet pak në vend) drejt pikës 3. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa. Shif skicën Nr. 2.
- Kamba e majtë afrohet pranë së djathtës e thyeme, në majë të gishtave (kamba e djathtë dhe trupi drejtohen në pozicionin normal), me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Në të njejtën kohë, dora e majtë vendoset mbrapa në bel e thyeme, kurse e djathta del nalt.

— Ulje dhe ngrajtje e lehtë me të dyja kambët në vend. Në të njejtën kohë, dora e majtë qëndron mbrapa në bel, kurse e djathta del përpara tue rrotullue shaminë përmbrenda.

Masa V—VI

Në masën V—VI përsëritet lëvizja e masës III—IV e figurës së dytë.

Formula ritmike e variacionit të figurës së dytë.



libretto


KËLLIÇOJA E PARË

Transkr. M. Daku

Largo  $\text{♩} = 56$

Musical score for "KËLLIÇOJA E PARË". The score is written on a grand staff with two systems of staves. The first system includes the vocal line (CURLJA) and the piano accompaniment (LODRA). The vocal line features a melodic line with various ornaments and slurs, and a bass line with chords. The piano accompaniment consists of a right-hand part with chords and a left-hand part with chords. The score is marked "Largo" with a tempo of  $\text{♩} = 56$ . The key signature is one flat (B-flat major/D minor). The score includes various musical notations such as slurs, ornaments, and dynamic markings.

## KRAH MË KRAH



Skica Nr. 5

Rasti: luhet në të gjitha rastet.

Gjinia: valle burrash.

Formacioni: në gjysëm rrethi.

Të kapunit: valltarët kapen krah më krah.

Koha: 2/4.

Andantino



= 66.

### Karakteristikat

Krah më krah asht valle burrash. Luhet në gjysëm rrethi të hapun. Valltarët janë të kapun krah më krah. Vallja asht e përbame prej hecjes (shetitjes) dhe kërcimit.

Në hecje, që asht çasti përpara fillimit të kërcimit, valltarët, hecin me hap të lirë njeni mbas tjetrit nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit, ndërsa curlja dhe lodra bijnë. Në çastin e dhun për ta fillue vallen, valltarët kapen krah më krah.

Kërcimi (pjesa e parë e valles) përbahet prej figurës së parë, së dytë, që janë figurat bazë të valles dhe prej një figure tjetër, e cila asht variation i figurës së parë.

Lëvizjet karakteristike të valles janë: ngrejtje e kambës të thyeme përpara, anash; lëvizje me rrotullimin e trupit, hudhje prej njenës kambë në tjetrën, ulje e madhe (grand plye) etj. E gjithë vallja ekzekutohet në dymbëdhjet masa muzike. Zakonisht mbas mbarimit vallja ripërsëritet prej fillimit deri në fund.

### Hecja

Mbasi ka fillue me ra curlja dhe lodra, kërcimtarët, të shkëputun njeni prej tjetrit, hecin me hap të lirë në rreth nga e djathta. Bahet gjysëm, ose gati një rreth i plotë, deri sa i pari i valles ndalet për ta fillue kërcimin (zakonisht nuk ka caktim, mund të zgjasi katër masa, ose ma tepër). Mbas kësaj, valltarët kapen krah më krah në gjysëm rrethi, skica Nr. 4. në dy masat e para dhe, në dy masat e dyta të frazës muzikore në vazhdim, ata e nxjerrin kambën e djathtë, të thyeme, tue e rrotullue dhe e vendosin përsipër gjunit të majtë. I pari e çon dorën bashkë me shaminë nalt.


39086

## Pjesa e parë

### Figura e parë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën 2/4.
- Qëndrimi fillestar i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosun në gjysëm rrethi me fytyrë përpara.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

### Lëvizja



### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I



- Kamba e djathtë vendoset nga e djathta, pak e thyeme (e majta gjithashtu thyhet në vend), me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi asht i mbështetur mbi të dyja kambët. Duert: i pari e ul dorën anash, gjithashtu dhe i fundit tue lëvizë shaminë.



- Hap kali i vogël me të majtën pak të thyeme. Duert: i pari e nxjerr dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.

#### Masa II



- I njejt hap me të djathtën. Duert: i pari e çon dorën anash, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.



- Kamba e djathtë çohet në vend, pak në majë të gishtave dhe ulet, ndërkaq e majta del e thyeme përpara 90° me thembrën përmbrenda. Duert: i pari e nxjerr dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.

#### Masa III



- Kamba e majtë vendoset anash nga e majta, pak e thyeme (e djathta gjithashtu thyhet në vend), me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Duert: i pari e çon dorën nëalt, pak të thyeme kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.



- Kamba e majtë çohet në pozicionin normal, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8, ndërkaq e djathta del përpara e thyeme 90° me thembrën përmbrenda. Duert e të dy valltarve qëndrojnë n'atë pozicion tue lëvizë shaminë.


#### Masa IV



— Kamba e majtë thyhet dhe ngrehet në vend, ndërkaq e djathta e thyeme shkron anash, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 1. Duert qëndrojnë në atë pozicion të lëvizës shaminë. Skica Nr. 6.



— Kamba e majtë thyhet dhe ngrehet në vend, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8, ndërkaq e djathta del përpara e thyeme 90° me thembrën përmbrenda. Duert: i pari e nxjerr dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend të rrotullue shaminë.



Skica Nr. 6

Formula ritmike e figurës së parë




Variacioni i figurës së parë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën 2/4.
- Pozicioni i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosur në gjysëm rrethi me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8.
- Lëvizjet ekzekutohen nga e djathta me rrotullimin e trupit.



## Lëvizja



Përshkrimi i lëvizjes

### Masa I



- Kamba e djathtë vendoset nga e djathta, pak e thyeme (e majta gjithashtu thyhet në vend), me rrotullimin e trupit  $90^\circ$  nga e djathta. Trupi asht i mbështetur me të dyja kambët. Duert për të gjithë valltarët: e majta del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.



- Hap kali i vogël me të majtën, pak të thyeme, me kthimin e trupit  $90^\circ$  nga e djathta. Duert: e majta ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.

### Masa II



- I njehti hap me të djathtën, me kthimin e trupit  $180^\circ$  nga e djathta. Valltarët kapen krah më krah: i pari dhe i fundit e nxjerrin dorën anash.



- Kamba e djathtë çohet në vend, pak në majë të gishtave dhe ulet, ndërkaq e majta del përpara e thyeme  $90^\circ$ , me thembrën përmbrenda. Duert: i pari e nxjerr dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend.

Masa III-IV: në masën III-IV përsëritet lëvizja e masës I-II e figurës së parë.


Formula ritmike e variacionit të parë



Figura e dytë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën  $2/4$ .
- Pozicioni i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosun në gjysëm rrethi, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

## Lëvizja



## Përshkrimi i lëvizjes

### Masa I

- Kamba e djathtë vendoset nga e djathta, pak e thyeme (e majta gjithashtu thyhet në vend), me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi asht i mbështetur mbi të dyja kambët. Duert: i pari e ul dorën anash, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.
- Hudhje prej kambës së djathtë mbi të majtën të thyeme (demie plyie) përpara drejt pikës 3, ndërkaq e djathta çohet e thyeme mbi tokë. Duert: i pari e nxjerr dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë. Skica Nr. 7.




Skica Nr. 7

### Masa II

- Kamba e djathtë vendoset përpara, në të njejtën kohë ulje e madhe (grand plyie) mbi të dyja kambët në majë të gishtave (gjunjët janë të hapuna). Duert qëndrojnë n'atë pozicion. Skica Nr. 8.





Skica Nr. 8



- Kamba e djathtë çohet në vend, pak në majë të gishtave dhe ulet, ndërkaq e majta del përpara e thyeme  $90^\circ$  me thembrën përmbrenda. Duert: i pari e çon dorën nalt, pak të thyeme, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.

### Masa III



- Ulje e madhe (grand plye) mbi të dyja kambët në vend me kthimin e trupit  $180^\circ$  nga e majta. Trupi mbështetet mbi të dyja kambët të hapuna në majë të gishtave. Duert: i pari e ul dorën të thyeme përpara gjoksit, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.



- Kamba e majtë çohet në vend, pak në majë të gishtave, ndërkaq e djathta del përpara e thyeme  $90^\circ$  me thembrën përmbrenda. Duert: i pari e çon dorën nalt, pak të thyeme, kurse i fundit e mban në vend tue lëvizë shaminë.


### Masa IV



- Kamba e majtë thyhet dhe ngrehet në vend, ndërkaq e djathta e thyeme shkon anash, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 1. Duert qëndrojnë n'atë pozicion tue lëvizë shaminë. Shif skicën Nr. 6.



## PËR PJETA



Skica Nr. 9

Rasti: luhet në të gjitha rastet.

Gjinia: valle burrash.

Formacioni: në rreth të mbyllun.

Të kapunit: sejcili valltar kërcen veças.

Koha: 7/8.

all. tto



= 160

### Karakteristikat

Përpjeta asht valle burrash. Luhet në rreth të mbyllun. Sejcili valltar kërcen veças. Vallja asht e përbame prej: hecjes (shetitjes) dhe kërcimit.

Në hecje, që asht çasti përpara fillimit të kërcimit, valltarët hecin me hap të lirë njeni mbas tjetrit nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepavet të sahatit, ndërsa curlja dhe lodra bijnë.

Kërcimi (pjesa e parë e valles) përbahet prej figurës së parë, së dytë, së tretë dhe së katërt, të cilat përbajnë lëvizjet bazë të valles dhe, prej dy figurash të tjera, të cilat janë variacionet e figurës së dytë. Figura e parë ekzekutohet në vend, ku rolin kryesor e luejnë lëvizjet e duerve.

Lëvizjet karakteristike të valles janë: lëvizje duersh, ngrajtje e nje-nës, apo e tjetrës kambë përpara e thyeme, ose me hudhje; lëvizja e mesit, rrotullime me hudhje, ngrajtje e kambës anash, hudhje me të dyja kambët, ulje e madhe (grand plyie) me rrotullimin e trupit etj. Lëvizjet janë të ngadalëshme, të qeta, por shumë shpejt ato rriten; në këtë mënyrë, lëvizjet, tue mos i humbë nuancat e tyne deri në fund, karakterizo-

hen nga një dinamikë që vjen gjithnjë tue u rritë. E gjithë vallja ekzekutohet në dymbëdhjet masa muzike. Zakonisht mbas mbarimit ajo ripërsëritet, vetëm me ndryshimin nga hera e parë se, dinamika e kërcimit në këtë rast asht vazhdimisht e gjallë.

## H e c j a


Mbasi ka fillue me ra curlja dhe lodra, kërcimtarët, të shkëputun njëni prej tjetrit, hecin me hap të lirë në rreth nga e djathta; në dorën e djathtë mbajnë shaminë. Bahet gjysëm, ose gati një rreth i plotë, deri sa i pari i valles ndalet për ta fillue kërcimin (zakonisht nuk ka caktim, mund të zgjasi dy masa, ose ma tepër). Simbas të parit veprojnë të gjithë. Skica Nr. 9.

## P j e s a e p a r ë

### Figura e parë

- Përmbledh një masë muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni fillestar i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth, në distanca të barabarta njëni prej tjetrit, me fytyrën nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në vend.

## L ë v i z j a



### Përshkrimi i lëvizjes

## Masa I



- Kamba e djathtë qëndron pranë së majtës, pak e thyeme, në majë të gishtavet. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njëjtën kohë, dora e majtë asht në pozicionin normal, kurse e djathta çohet nalt me shaminë.



- Dora e majtë del përpara gjoksit e thyeme (dora e djathtë qëndron n'atë pozicion), me kthimin e trupit gjysëm djathtas në vend drejt pikës 2.



- Dora e majtë ulet poshtë në pozicionin normal, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1, ndërkaq e djathta del përpara tue rrotullue shaminë n'ajër.


## Formula ritmike e figurës së parë



Figura e dytë

- Përmbledh dy masa muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepavet të sahatit.

## Lëvizja



Përshkrimi i lëvizjes

### Masa I



- Kamba e majtë thyhet pak në vend, ndërkaq e djathta çohet përpara e thyeme 45°. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara, pak të thyeme.



- Kamba e djathtë vendoset nga e djathta, pak e thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.



- Kamba e majtë afrohet, pak e thyeme pranë së djathtës. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.



- Hap i vogël me të djathtën pak të thyeme nga e djathta. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.



- Pushim.

### Masa II



- Kamba e djathtë qëndron e thyeme në vend, ndërkaq e majta çohet përpara e thyeme 45°, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara, pak të thyeme.



- Kamba e majtë vendoset anash, pak e thyeme (e djathta çohet në pozicionin normal) drejt pikës 7. Në të njejtën kohë, të dyja duert ulen anash, (e djathta rrotullon shaminë përmbrenda).



Skica Nr. 10



- Kamba e majtë thyhet pak në vend, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2, ndërkaq e djathta çohet e thyeme me thembrën përjashta. Në të njejtën kohë, të dyja duert qëndrojnë n'atë pozicion. Skica Nr. 10.



- Kamba e djathtë vendoset përpara, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8. (trupi shkon pak mbrapa), ndërkaq e majta çohet e thyeme mbrapa, shumë pak mbi tokë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supet (supi i majtë shkon mbrapa, i djathti përpara).



- Kamba e majtë vendoset mbrapa, pak e thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 1. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supet (supi i majtë shkon përpara, i djathti mbrapa).



- Pushim


## Formula ritmike e figurës së dytë



### Variacioni i parë i figurës së dytë

- Përmbledh dy masa muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

### Lëvizja



### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I




- Kamba e majtë çohet në majë të gishtave në vend dhe ulet, ndërkaq e djathta del përpara e thyeme 45°. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara, pak të thyeme. Skica Nr. 11.




Skica Nr. 11






— Kamba e djathtë vendoset nga e djathta e thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi shkon pak përpara dhe mbështetet mbi kambën e djathtë. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.




— Hap me të majtën pak i thyem. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.




— I njejtë hap me të djathtë. Trupi mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.

7 — Pushim.


## Masa II




— Kamba e djathtë çohet në majë të gishtave në vend dhe ulet, ndërkaq e majta del përpara e thyeme 45°, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Në të njejtën kohë të dyja duert dalin diagonal përpara pak të thyeme.




— Kamba e majtë vendoset anash nga e majta drejt pikës 7. (e djathta në këtë çast çohet në pozicionin normal). Në të njejtën kohë, të dyja duert ulen anash tue lëvizë (e djathta rrotullon shaminë përmbrenda).



— Kamba e majtë thyhet në vend, me kthimin e trupit gjysëm djathtas, drejt pikës 2, ndërkaq e djathta çohet e thyeme me thembren përjashta. Në të njejtën kohë, të dyja duert qëndrojnë n'atë pozicion. Shif skicën Nr. 10.




— Kamba e djathtë vendoset përpara, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8. (trupi shkon pak mbrapa), ndërkaq e majta çohet e thyeme mbrapa mbi tokë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supet (supi i majtë shkon mbrapa, i djathti përpara).



— Kamba e majtë vendoset mbrapa e thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 1. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supet (supi i majtë shkon përpara, i djathti mbrapa).

7 — Pushim.


Formula ritmike e variacionit të parë



## Variacioni i dytë i figurës së dytë






- Përmbledh dy masa muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

### Lëvizja




### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I

-  — Hudhje mbi kambën e majtë në vend të thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2., ndërkaq e djathta kryqzohet përpara e thyeme 90° me thembrën përjashtë. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara, pak të thyeme.
-  — Kamba e djathtë vendoset nga e djathta e thyeme drejt pikës 3. Trupi shkon pak përpara dhe mbështetet mbi kambën e djathtë. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
-  — Hudhje nga kamba e djathtë mbi të majtën të thyeme, me rrotullimin e trupit 360° nga e djathta, ndërkaq e djathta qëndron e thyeme pranë së majtës mbi tokë. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.
-  — Kamba e djathtë vendoset nga e djathta e thyeme drejt pikës 3. Trupi mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
-  — Pushim.

#### Masa II

-  — Hudhje me kambën e djathtë në vend, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1, ndërkaq e majta çohet përpara e thyeme 90°. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara pak të thyeme.

- Kamba e djathtë thyhet dhe çohet në vend, ndërkaq e majta afrohet pranë së djathtës e thyeme mbi tokë. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta n'atë pozicion ku asht e rrotullon shaminë përmbrenda.
- Kamba e majtë vendoset anash nga e majta drejt pikës 7. Të dyja duert qëndrojnë n'atë pozicion.
- Kamba e majtë thyhet në vend, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2, ndërkaq e djathta çohet e thyeme me thembrën përjashta. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin anash pak të thyeme. Shif skicën Nr. 10.
- Kamba e djathtë vendoset përpara, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 8 (trupit shkon pak mbrapa), ndërkaq e majta çohet e thyeme mbrapa mbi tokë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supet (supi i majtë shkon mbrapa, i djathti përpara).
- Kamba e majtë vendoset mbrapa e thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 1. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë. Në të njejtën kohë, të dyja duert në pozicionin ku janë lëvizin bashkë me supin (supi i majtë shkon përpara, i djathti mbrapa).
- Pushim.

Formula ritmike e variacionit të dytë





Figura e tretë


- Përmbledh dy masa muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

Lëvizja




## Përshkrimi i lëvizjes

### Masa I

- 
- Hudhje me kambën e majtë në vend të thyeme, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2, ndërkaq e djathta kryqëzohet përpara e thyeme 90° me thembrën përjashta. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara, pak të thyeme.
  - Kamba e djathtë vendoset nga e djathta e thyeme drejt pikës 3. Trupi shkon pak përpara dhe mbështetet mbi kambën e djathtë. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
  - Hudhje e vogël, nga e djathta, nga kamba e djathtë mbi të majtën në majë të gishtave. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme.
  - Hap i madh nga e djathta me të djathtën të thyeme (edhe e majta thyhet në vend). Trupi mbështetet mbi të dyja kambët. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara e thyeme, kurse e djathta ulet diagonal mbrapa.
  - Pushim.

### Masa II

- 
- Hudhje me kambën e djathtë në vend të thyeme, me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1, ndërkaq e majta çohet përpara e thyeme 90°. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin diagonal përpara pak të thyeme.
  - Kamba e majtë vendoset anash nga e majta drejt pikës 7, ndërkaq e djathta çohet e shtrime anash 45°. Në të njejtën kohë, të dyja duert ulen anash të shtrime. Skica Nr. 12.
  - Kamba e djathtë vendoset pranë së majtës. Në të njejtën kohë, të dyja duert bajnë një rreth rrotullim (diagonal mbrapa, nalt, përpara, përsëri diagonal mbrapa). Skica Nr. 13.
  - Pushim.
  - Të dyja kambët thyhen pak në vend. Duert qëndrojnë n'atë pozicion.

Formula ritmike e figurës së tretë





Skica Nr. 12




Skica Nr. 13

### Figura e katërt

- Përmbledh tre masa muzikore në kohën 7/8.
- Pozicioni i trupit: valltarët janë të vendosun në rreth me fytyrë nga qendra.
- Lëvizjet ekzekutohen drejt qendrës së rrethit.

### Lëvizja



### Përshkrimi i lëvizjes

#### Masa I

- Hudhje me të dyja kambët mbi të majtën të thyeme diagonal përpara majtas, ndërkaq e djathta kryqzohet e thyeme pak mbrapa së majtës. Në të njejtën kohë, dora e majtë del anash, kurse e djathta del përpara gjoksit e thyeme. (Skica Nr. 14).



Skica Nr. 14

— E njehta hudhje me të djathtën diagonal përpara djathtas.

— Vendosje e kambës së majtë, pak nga e majta, me ulje të madhe (grand plyie) mbi të dyja kambët e hapuna (e djathta në majë të gishtave). Trupi shkon pak përpara. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta del përpara e thyeme. Skica Nr. 15.

— Pushim.



Skica Nr. 15

## Masa II

— Rrotullim në vend tue u ngrejtë me të djathtën në majë të gishtave, ndërkaq e majta qëndron e thyeme pranë së djathtës mbi tokë. Në të njejtën kohë, të dyja duert dalin gjysëm anash. Skica Nr. 16.

— Kamba e majtë vendoset anash nga e majta në majë të gishtave, pak e thyeme (e djathta ulet me gjith shuellin). Në të njejtën kohë, të dyja duert qëndrojnë n'ate pozicion. Skica Nr. 16.

— Thyemje (demie plyie) në vend e të dyja kambëve. Trupi asht i mbështetur mbi të dyja kambët dhe i kthyer gjysëm djathtas, pak i përkulur mbrapa. Në të njejtën kohë, dora e majtë del përpara gjoksit e thyeme, kurse e djathta shkon diagonal mbrapa. Skica Nr. 17.



Skica Nr. 16



Skica Nr. 17



— Ulje e madhe (grand plye) në vend mbi të dyja kambët të hapuna (e djathta në majë të gishtave), me kthimin e trupit drejt pikës 1. Trupi shkon pak përpara. Në të njejtën kohë, dora e majtë ulet diagonal mbrapa, kurse e djathta tue u rrotullue del përpara e thyeme. Shif skicën nr. 15.



— Pushim

**Masa III:** Në masën III përsëritet lëvizja e masës II e figurës së katërt.

Formula ritmike e figurës së katërt





# PERPJETA


Allegretto  $\text{♩} = 160$

Transkr: M Jau

Musical score for "PERPJETA" featuring two parts: CURLJA and LODRA. The score includes melodic lines with various ornaments and rhythmic patterns, and a bass line with chords. The top part, CURLJA, is written in a treble clef with a key signature of one flat and a 2/4 time signature. The bottom part, LODRA, is written in a bass clef. The score consists of ten systems of music. The first system includes the title "CURLJA" and the first part of the melody. The second system includes the title "LODRA" and the beginning of the bass line. The score is heavily ornamented with various symbols such as "D", "S", "d", "s", and "y" with accents and slurs, indicating specific performance techniques. A "360°" marking is present in the third system. The piece concludes with a double bar line at the end of the tenth system.

## SHKEPZA

(Varianti i parë)



Skica Nr. 18

Rasti: luhet në të gjitha rastet.


Gjinia: valle burrash.

Formacioni: në gjysëm rrethi.

Të kapunit: valltarët kapen krah më krah.

Koha: 2/4.

all. tto

 = 150

### Karakteristikat

Shkepza asht valle burrash. Ekzekutohet në variante të ndryshme, nga të cilët do të paraqesim vetëm dy. Luhet në gjysëm rrethi, me nga dy, katër, gjashtë deri në dhjet persona. Vallja në të dy variantet ka të njëjtin konstrukt dhe përbahet prej: hecjes (shetitjes) dhe kërcimit.

Në hecje, që asht çasti përpara fillimit të kërcimit, valltarët hecin me hap të lirë nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit, ndërsa curlja dhe lodra bijnë.

Kërcimi i variantit të parë (pjesa e parë e valles) përbahet prej figurës së parë dhe prej një figure tjetër, e cila asht variacion i figurës së parë, kurse kërcimi i variantit të dytë (pjesa e parë e valles) përbahet prej dy figurave.

Në të dy variantet këto figura ekzekutohen vetëm prej valltarit të parë, ndërsa valltarët e tjerë e shoqnojnë atë me qëndrime në vend tue e shikue, ose me hapa të vegjël, pak të thyem.

Asht karakteristikë gjatë kërcimit kur valltari i parë ekzekuton lëvizjen tue shkëpue (tue çalue), valltari i dytë, që në këtë rast asht partner i të parit, i ban hapat pak të thyem, i treti ma pak dhe kështu deri te i fundit. Kjo asht karakteristikë për të dy variantet.

Lëvizjet karakteristike të variantit të parë janë: hap çalamani, kryqzim i kambës së thyeme përpara n'ajër, vendosja e kambës në vend, hap normal etj.

Lëvizjet karakteristike të variantit të dytë janë: hap çalamani, ngrej-tje e kambës së thyeme përpara n'ajër, hap normal mbrapsht, ulje e madhe (grand plyie) mbi të dyja kambët në majë të gishtave; rrotullim në vend 360° tue u ngrejtë mbi të majtën në formë spirale etj. Mbasi mbaron, vallja mund të ripërsëritet.

## H e c j a


Mbasi ka fillue me ra curlja dhe lodra, kërcimtarët, të shkëputun njeni prej tjetrit, hecin me hap të lirë në rreth nga e djathta. Bahet gjysëm, ose gati një rreth i plotë, derisa i pari i valles ndalet për ta fillue kërcimin (zakonisht nuk ka caktim, mund të zgjasi katër masa ose ma tepër). Simbas të parit veprojnë të gjithë. Skica Nr. 18.

### Pjesa e parë

#### Figura e parë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën 2/4.
- Qëndrimi fillestar i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosun në gjysëm rrethi me fytyrë përpara.
- Lëvizjet ekzekutohen në vend dhe në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.


#### Lëvizja




#### Përshkrimi i lëvizjes


##### Valltari i parë


###### Masa I

 — Kamba e djathtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.


 — Kamba e djathtë vendoset në vend pranë së majtës.


###### Masa II

 — Kamba e majtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.


 — Kamba e majtë vendoset në vend pranë së djathtës.

###### Masa III

 — Kamba e djathtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.

 — Kamba e djathtë vendoset anash nga e djathta (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2.

###### Masa IV

 — I njejtë hap me të majtën.

- Hap me të djathtë anash nga e djathta (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1.

Valltarët e tjerë.

Masa I-II: në këto dy masa valltarët qëndrojnë në vend tue pa të parin kur kërcen.

Masa III-IV: në këto dy masa valltarët hecin me hapa të vegjël.


Formula ritmike e figurës së parë



Variacioni i figurës së parë

- Përmbledh tetë masa muzikore në kohën 2/4:
- Qëndrimi i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosun në gjysëm rrethi me fytyrë përpara.
- Lëvizjet ekzekutohen në vend dhe në rreth nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

Lëvizja



Përshkrimi i lëvizjes

Valltari i parë

Masa I



- Kamba e majtë kryqëzohet përpara e thyeme 90° n'ajër. Skica Nr. 19.



- Kamba e majtë vendoset në vend pranë së djathtës.

Masa II



- Kamba e djathtë kryqëzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.



- Kamba e djathtë vendoset anash nga e djathta (pika 3), pak e thyeme, në majë të gishtave, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi qëndron mbi të dyja kambët pak i përkulun përpara, i mbështetur mbi dorën e djathtë, e cila shtrëngon kofshën e djathtë. Skica Nr. 20.



Skica Nr. 19



Skica Nr. 20



Skica Nr. 21

### Masa III



— Hap i thyem (demie plyie) me të majtën anash nga e djathta (pika 3), ndërkaq dora e djathtë e mbështetur mbi kofshën e djathtë e shtyn ate nga jashtë. Skica Nr. 21.



— Hap me të djathtën, pak i thyem, në majë të gishtave. Shif skicën Nr. 20.

### Masa IV



— Hap i thyem (demie plyie) me të majtën, ndërkaq dora e djathtë e mbështetur mbi kofshën e djathtë e shtyn ate nga jashtë. Shif skicën nr. 21.



— Hap me të djathtën anash nga e djathta (pika 3), me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1. Dora e djathtë shkon mbrapa. Trupi çohet në pozicionin normal.

### Masa V



— Kamba e majtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.



— Kamba e majtë vendoset në vend pranë së djathtës.

### Masa VI



— Kamba e djathtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.



— Kamba e djathtë vendoset nga e djathta, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2.

### Masa VII



— Hap me të majtën anash nga e djathta (pika 3).



— Hap me të djathtën anash nga e djathta (pika 3), me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1.

### Masa VIII



— Kamba e majtë kryqzohet përpara e thyeme 90° n'ajër.




— Kamba e majtë vendoset në vend pranë së djathtës.

Valltarët e tjerë.


### Masa I




— Pushim.


 — Pushim.


**Masa II**

 — Pushim.


 — Hap i vogël me të djathtë nga e djathta, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2.


**Masa III**

 — I njehti hap me të majtën.


 — I njehti hap me të djathtë.


**Masa IV**

 — I njehti hap me të majtën.


 — I njehti hap me të djathtë, anash nga e djathta, (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1.


**Masa V**

 — Pushim.


 — Pushim.


**Masa VI**

 — Pushim.

 — Hap i vogël me të djathtë anash nga e djathta (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2.

**Masa VII**

 — I njehti hap me të majtën.

 — I njehti hap me të djathtë, anash nga e djathta, (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm majtas drejt pikës 1.

Masa VIII

— Pushim.

— Pushim.

- Formula ritmike e variacionit të figurës së parë

♩ | 8x

SHKEPZA

Allēgretto ♩.150

transkr: M. Daiu.

Musical score for SHKEPZA, featuring two staves: CURLJE and LODRA. The score includes rhythmic notation, accidentals, and dynamic markings.

**CURLJE**    S    D    D    S    S    D

**LODRA**    S    D    D    S    S    D

**CURLJE**    S    D    S    D    D    S

**LODRA**    S    D    S    D    D    S



## SHKEPZA


(Varianti i dytë)

Pjesa e parë

Figura e parë

- Përmbledh një masë muzikore në kohën 2/4.
- Pozicioni fillestar i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë të vendosun në gjysëm rrethi me fytyrë përpara.
- Lëvizjet ekzekutohen nga e djathta në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të sahatit.

Lëvizja



Përshkrimi i lëvizjes

Valltari i parë

Masa I



- Hap me të djathtë, pak të thyeme, në majë të gishtave, anash nga e djathta (pika 3), me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2. Trupi qëndron mbi të dyja kambët, pak i përkulun përpara, i mbështetur mbi dorën e djathtë, e cila shtrëngon kofshën e djathtë. Shif skicën 20.



- Hap i thyem (demie plye) me të majtën, ndërkaq dora e djathtë e mbështetur mbi kofshën e djathtë e shtyn atë nga jashtë. Shif skicën 21.

Valltarët e tjerë

Masa I



- Hap i vogël me të djathtë, me kthimin e trupit gjysëm djathtas drejt pikës 2.



- I njejtë hap me të majtën.

Formula ritmike e figurës së parë




Figura e dytë

- Përmbledh katër masa muzikore në kohën 2/4.
- Qëndrimi i trupit: valltarët, të kapun krah më krah, janë vendosun në gjysëm rrethi të kthyer gjysëm djathtas drejt pikës 2.
- Lëvizjet ekzekutohen mbrapsht në drejtim me lëvizjen e akrepave të sahatit.

## Lëvizja



### Përshkrimi i lëvizjes

#### Valltari i parë

##### Masa I



— Kamba e majtë qëndron në vend, pak e thyeme, ndërkaq e djathta çohet përpara e thyeme 90° n'ajër me thembrën përjashta. Dora e djathtë shkon mbrapa.



— Kamba e djathtë vendoset, pak e thyeme anash nga e majta (pika 7).

##### Masa II



— Kamba e majtë çohet përpara e thyeme 90° n'ajër, me thembrën përjashta.



— Ulje e madhe (grand plyie) me hudhje të vogël mbi të dyja kambët e hapuna në majë të gishtave.

##### Masa III



— Rrotullim në vend 360° tue u ngrajtë me të majtën në majë të gishtave, ndërkaq e djathta e thyemë mbështetet me thembër mbi gjunin e majtë. Duert dalin pak anash.



— Ulje e madhe (grand plyie) mbi të dyja kambët të hapuna në maje të gishtave.

##### Masa IV



— Kamba e djathtë çohet në pozicionin normal, pak e thyeme, ndërkaq e majta çohet përpara e thyeme 90° n'ajër me thembrën përjashta.



— Kamba e majtë vendoset, pak e thyeme, anash nga e majta (pika 7).

#### Valltarët e tjerë:

##### Masa I



— Pushim.



— Hap i vogël, me të djathtën anash nga e majta (pika 7).

Masa II



— Pushim.



— Hap i vogël, me të majtën anash nga e majta (pika 7).

Masa III



— Pushim.



— Hap i vogël, me të djathtën anash nga e majta (pika 7).

Masa IV



— Pushim.



— Hap i vogël, me të majtën anash nga e majta (pika 7).

Formula ritmike e figurës së dytë



35496.

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
DURRES

II numri

(Këtu mund të gjendet informata më e detajuar për librin dhe autorin)

III numri

## PASQYRA E LANDE'S

	Faqe
Parathënie .....	3
Hymje .....	5
Treguesi i shenjave .....	7
Këlliçoja e parë .....	11
Krah më krah .....	17
Përpyjete .....	24
Shkepza (Varianti i parë) .....	37
Shkepza (Varianti i dytë) .....	44